



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3447/2 prot.

Bajram Curri, me, 11 . 08.2022

VENDIM

Nr. 68 date 11.08.2022

PËR NËNSHKRIMIN E KONTRATËS SË GRANTIT PAS NJOFTIMIT TË SHPALLJES FITUES TË PROJEKTIT “Active Tropoja Youths for our Municipality (ATY4M)”.

dhe

ANGAZHIMIN E BURIMEVE FINANCIARE TË BASHKISË SË TROPOJËS PËR TË MBULUAR BASHKËFINANCIMIN EVENTUAL, KOSTOT E TVSH-SË, PLANIN E MIRËMBAJTJES DHE KOSTOT PËR VEPRIMIN E PROPOZUAR TË PËRFSHIRA NË BUXHETIN VJETOR AFAT-MESËM.

Keshilli i Bashkisë Tropojë ne mbledhjen e tij të datës 11.08 .2022, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Njësisë se Integritimit European dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Drejtorisë Ekonomike dhe Sektorit Juridik, në mbështetje te nenit në 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.2,pika 1.5 shkronja “a” dhe pika 1.6 shkronja “a”, neni 34 pika 6 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; I ndryshuar; Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Ligjit nr.68/2017 “Per financat e vetqerisjes vendore”,dhe në bazë të Ligjit 61/2015 “Për ratifikimin e Marrëveshjes mes Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian”:

VENDOSI:

1. Të miratojë zbatimin e projektit “Active Tropoja Youths for our Municipality (ATY4M)”, ku Bashkia Tropojë aplikoi në thirrjen e dytë e hapur për grante nga Europe for Municipalities (EU4M) dhe ka fituar të drejtën për ta zbatuar këtë projekt duke përfituar asistencë financiare gjatë zbatimit të tij.
2. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë së Tropojës për nënshkrimin e kontratës së grantit.

3. Të miratojë angazhimin e burimeve financiare të Bashkisë Tropojë për të mbuluar bashkë-financimin eventual të bashkisë, kostot e TVSH-së, planin e mirëmbajtjes dhe kostot për veprimin e propozuar të përfshira në buxhetin vjetor afat-mesëm për zbatimin e projektit **“Active Tropoja Youths for our Municipality (ATY4M)”**:
- Kohëzgjatja e projektit: 8 muaj
 - Koordinator i projektit: Bashkia Tropojë
 - Partnerë i projektit: Shoqata “Udhëtim i Lirë - Libberi di viaggiare”
 - Buxheti total i projektit: 53, 848 EURO
 - Kontributi i BE-së: 49,848 EURO
 - Bashkë-financimi: 4000 EURO
4. Në bazë të nenit 34 pika 6 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në të cilin ndër të tjera thuhet: *“Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa defiçit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”* të mbajë në konsideratë në hartimin e projekt buxhetit të radhës të Bashkisë, pa tejkalar kufijtë e fondeve të përcaktuara në buxhetin vjetor për vitin 2022, një fond të posaçëm për projektin “Active Tropoja Youths four our Municipality (ATY4M)”.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen strukturat përgjegjëse të sipërcituara të bashkisë Tropojë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI KESHILLIT
Shotë BASHAJ

